

Fletushkë e Seksionit Letrar  
të ShK Shqiptare „MIGJENI”  
Glasilo literarne sekcije  
KD Albancev „MIGJENI”

403608

# ALTERNATIVA

**3-4**

Ljubljana, gush-shtator 1989  
avgust-september 1989



## KATËR - PESË FJALË

1. Mos po na dëgjon Ali Shukria: athua sa shqiptarë ka në botë?! Në Jugosllavi nuk dihet as nuk bën të dihet sa janë. Kudo janë. Bizanti i Ri njih:shqiptarët e ndershëm dhe separatistët. Është fundamentalizmi vetëqeverisës shqiptarët jashtë Atdheut i ndanë në besnikë dhe ekstremistë. Njeriun e përjashtuar nga Jugosllavia duan ta përjashtojnë edhe nga Evropa. Mos janë gjallë Hitleri e Musolini?!

2. Luigj Gurakuqi, Hasan Prishtina, Shota e Azem Galica po vriten për të dytën herë. Vrasës: bijtë më të mirë të kombeve e kombësive tona në Kosovë e në Serbi. Si në Kinë si në Prishtinë, si në Tien An Men si në Prizren...

U hoqën disa nga masat e jashtëzakonshme. Shtuan vetëm disa njësi milicësh specialë dhe tankesh. Dr. Gani Jashari, përsëdytë e përsërit: diferencimi nuk është dhunë mbi inteligjencien shqiptare! Doktor Ganiu është besnik i rrast dhe nuk bën të mos i besosh. Ne në Lubjanë e kemi pak më lehtë derisa besnikët të mos dërgojnë pak tanke edhe kah veriu. Diferencimi vazhdon deri në stabilizim. Pse të mos i quajmë tanket stabilizatorë...

3. Minatorët e Kosovës në grevë. Azem Vllasi studjon Aktakuzën që i ngritën ata që i ngriti vetë. Azem: Burgu, ku gjendesh ti, u provua nga ata që ti më 1981 i shpalle kundërrevolucionare. Dëshirojmë të dalësh në liri. As Jugosllavisë as Serbisë nuk u bëre kurrënjë faj...Kosova ka zemër të gjerë...

4. Gjuro Kozar shkroi në Oslobogjenje një koment rreth aktivitetit të "Migjenit" të Lubjanës, Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut në Kosovë, rreth Alternativës, meje e disa të tjerëve. Komenti im: Gjuro Kozar ka të drejtë të rrejë dhe le të rrejë në më shumë ekzemplarë. Rrena e tij ishte e shkruar me alfabet cirilik!

5. A stabilizohet Kosova me "shqiptarë të ndershëm"?!

Salih Kabashi



# KUR DO TË DALË E REJA...

ALTERNATIVA jonë e bashkë me të edhe gjithë Shoqata Kulturore e Shqiptarëve MIGJENI po bën hapat e parë. Në faqet e fletushkës sonë, Seksioni Letrar i Shoqatës, i ndihmuar nga nga të gjithë anëtarët e saj dhe miqtë e ALTERNATIVËS bëri punë të lavdërueshme, duke vënë themele të sigurta dhe duke shprehur shpirtin e saj të veçante.

ALTERNATIVA hapi dyert për të gjithë ata që kanë për të thënë diçka sepse hapsira e uniformuar nuk lë vend për mendime të lira. Asaj i dhemb çdo kockë nga mendimi i shfaqur i shqiptarëve për shqiptarët.

Po s'punuakan vetëm ata të Seksionit Letrar. Salih Hasani, palodhur stërvit ekipin e futbollit. Këtij don t'ia kalojë Ilir Elezkurtaj me orkestrinën e çiftelive. Mjeshtrit e çiftelive e bilbilat e melosit popullor u këndojnë pranverave e verave tona po edhe vjeshtës që po vjen-ardhtë e bardhë...

(Përkthyesit presin fjalorët se pa ta, duket se nuk u vete...Medicina si duket s'paska fort prirje aleance me artin dramatik...Së shpejti presim lindjen e komedisë me titull UDHËHEQËSI I DRAMËS NË MUNGESË TEKSTESH SHKRUAN VETË NJË DRAMË...).

...në Beograd është lirë letra-gjysmë faqeje i kush-tuan Alternativës...

"Në ditë të vështirë njihen burrat", thotë populli.

Ne patëm nevojë e populli na ndihmon me ndihma morale materiale. I falënderojmë të gjithë që ndihmuan daljen e dy numrave të parë. Fletëfalënderimi e keni ALTERNATIVËN 3.

Nga Maribori kemi një telefon:" Or, taj, mo luj me mou po m'defto far thotë ai redaktori, si e kur do vej e treta?...Si be jo...e lexova pikë për pikë. Nuk mora një, dhjetë i mora, va ndava shokëve...Si jo or taj, do gjej kohë do reskiri edhe ni sahat pi gjumit. Gji ti bajsh gjumit... Të venë n'pajth t'nanës..."

Telefoni i dytë nga Kranji:Cka u bë kjo punë o vëlla, sot erdha nga Lubjana, nuk më pyet kush se çfarë pazari bana po a na prune ALTERNATIVËN. 50 copë shkuan si hallvë. Vëllaunga Kosova përmes telefonit më thotë"çoma çat t'renë"...


-Mora nja dhet copa, bisedonin ata të Malësisë. Tuzi do mëshumë,ulçinakët na hidhërohen,në Tivar priftit duhet dërguar disa, 900 vjet i bën kisha atje, ajo kishë që është e gjithë shqiptarëve.

Në kohë të vështirë u linte ALTERNATIVË...Këto kohëra do të të kalisin ty dhe ne me ty. Derisa Dedijeri merret me "racizmin" slloven, Rrahmani e Sllobodani kërkojnë t'at shpënë diferencimin në veriperëndim. C'fi bësh kur me demokracinë merren ata që bëjnë dhunën.

Rrahmani ka gjetë ilaçin për të mëkëmbë ekonominë e Kosovës:ekspertët e Krahinës i dërgoi për specializim në Vranjë e Leskoc...

Kosova e pastër etnike e bëri bozë fjalorin bajat të forcave të shëndosha...Po burgjet e pastra etnike sa i takon të burgosurve politike? Rrahmani e Sllobodani angazhohen për ndërrim gjeneratash-amnesti se shqiptarët presin në radhë për të burg, apo jo...

FADIL DEMIRI





**Ismail Kadare:**

**MUNDJA E BALLKANASVE**

Lufta e Kosovës 1389

Fusha e mbytur në gjak e kllapi shumëgjuhëshe shtrihet tutje,  
Bashkë me ditën, ballkanasit, u thyen. Medet.  
Gadishulli i madh u gdhi Evropë e u ngrys Azi.

Gjëma vraponte rrafshnaltave, ikte grykave,  
Ato dot nuk e mbanin, ia kthenin maleve guļçonjës,  
Që e rrokullisnin pllajave, kërkonin ishuj për túa ndarë,  
Po ishujt s'gjendeshin. Gjithçka qe bërë katrahurë.

Furtunat në qiej u hutuan, vërtiteshin si të verbëra.  
Plakeshin në çast vetëtimat e binin nëpër balltëra.  
Qiejt po zhvisheshin. Mjerë ju, popuj të Ballkanit.  
Mjerë ju gjuhështerpa, me mbaresa si shkopiuj të thatë,  
me alfabete të përgjakur.

Si do t'iu djeg malli për të pjellë një vjershë. Medet.  
C' gjak do të derdhet për të ndrequr ç'u prish këtu. ftohtë,  
Ra nata. Një qiell i panjohur u shtri gjithkah, i ftohtë,  
Pastaj gjysmëhëna doli e mori në dorëzim gjithçka.





## Ismail KADARE

### Poraz Balkancev

Bitka na Kosovu 1389

Polje pokrito s krvjo in večjezičnim snom se širi v daljavo,  
skupaj z dnem se zlomijo Balkanci. Gorje.  
Veliki polotok je vzšel z Evropo in zahaja z Azijo.

Jok bega po planotah, bega po sedlih,  
a njegove teže ne morejo sprejeti, vračajo ga odmevnim planinam,  
ki ga valijo nižinam in iščejo zanj otoke, kjer bi ga porazdelili.  
A otokov ni. Vse sama zmešnjava.

Orkani v nebesih, zmedeni, divjajo kot slepi,  
bliiski v hipu ostarijo in padajo v blato.  
Nebesa se slačijo. Gorje vam, narodi Balkana,  
ja!ovi jeziki s končnicami kot suhe veje s krvavo pisavo.

Kako vas bo zgorela želja, da bi si rodili pesem. Gorje.  
Koliko krvi se bo prelilo, da se popravi, kar se je tu skazilo

Noč pada. Neznano nebo vse pokriva, hladno,  
polmesec vzhaja in prevzame vse v svoje roke.



# GJERGJ FISHTA

## GJUHA SHQYPE

1. Porsi kanga e zogut t'verës  
Qi vallzon n'blerim të Prillit  
Porsi i ambli flladi i eres  
Qi lmon gjit e drandofillit:  
Porsi vala e bregut t'detit,  
Porsi gjama e rrfes zhgjetare,  
Porsi ushtima e njij termetit,  
Njashtu a' gjuha jonë shqyptare.
2. Ah po; a' e ambel flala e sajë,  
Porsi gjumi m'nji kerthi,  
Porsi drita plot uzdajë,  
Porsi gazi i pa mashtri;  
Edhe ndihet tue kumbue,  
Porsi fleta e Kerubimit,  
Ka 'i bjen qiellvet tue flutru  
N't'zjartat valle t' ameshimit.
3. Pra, mallkue njai bir Shqyptari,  
Qi këtë gjuhë të Perendis,  
Trashigim, qi na la i Pari,  
Trashigim, s'i a len ai fmis;  
Edhe atij i u thaftë, po, goja,  
Qi e perbuzë këtë gjuhë hyjnore;  
Qi n'gjuhë t'huej, kur s' asht nevoja,  
Flet e tveten len mbas dore.
4. Në gjuhë shqype nanat t'ona  
Shi prej djepit na kanë thanun,  
Se asht një Zot, qi do t'a dona:  
Njatë, qi jeten na ka dhanun,  
Edhe shqyp na thanë se Zoti  
Per Shqyptarë Shqypnin e fali,  
Se sa t'enden stina e moti,  
Do t' a gzojn kta djalë mbas djali.



5. Shqyp na vetë, po pik' ma para,  
 N'agim t'jetës kur kemi shkue  
 Tue ndjekë flutra neper ara,  
 Shqyp ma s'pari kemi kndue:  
 Kemi kndue, po armët besnike,  
 Qi flakue kanë n'dorë t'Shqyptarëvet,  
 Kah kanë dekë kta per dhe t't'Parvet.
6. Në këtë gjuhë edhe njai Leka,  
 Qi 'i rruzllim mbretnin s'i a xuni,  
 Qi kah bijte ai, shkelte deka,  
 Shekllit mbarë ligjë t'randë i vuni;  
 Në këtë gjuhë edhe Kastriota  
 U pat folë njatyne ushtrive,  
 Qi sa t'ndrisë e diellit rrota,  
 Kanë me kenë ndera e trimnive.
7. Pra, Shqyptarë, çdo fes qi t'jini,  
 Gegë e Toskë, malci e qyteta,  
 Gjuhen t'uej kurr mos t'a lini,  
 Mos t'a lini sa t'jetë jeta,  
 Po per te gjithmonë punoni;  
 Pse, sa t'mbani gjuhen t'uej,  
 Fisi i juej, vendie zakoni  
 Kanë me u mbajtë larg kambet s'huej.
8. Nper gjuhë shqype bota mbarë  
 Ka me njohtë se ç'fis ju kini,  
 Ka me u njohtë ju per Shqyptarë:  
 Trima n'za sikurse jini.  
 Prandej, pra, n'e doni fisin,  
 Mali, bregu edhe Malcija  
 Prej njaj goje t'brohorisin:  
 Me gjuhë t'veten rrnoftë Shqypnija!



## Vorea Ujko

### MOMENT ARBERESH

E dua kumbonaren bizantine  
në mes të qiellit të kaltërt  
që pingultaz zbret në shpirtin tonë  
ndërsa mbrëmja merr ngjyrë manushaqje  
dhe vajza e ëndrravet  
bisedon kokulur  
në pragun e derës.  
Kështu përgjumshëm e vetmitar  
më vijnë parasysh  
lëvizjet e fëmijnisë  
dhe fytyra fatkeqe e Garantinës.  
Dhe arrin nga largësia e hijevet  
troku i kalit të Konstantinit  
që qaset me shpatulla vdekje.  
Dhe një jehonë arbëreshe  
depërton ajrin e zemrën  
e ngjitet përplotë si mister  
me flatrat e veta të lehta  
e rrok kacavarset e murit,  
rrok heshtjen,  
rrok gjakun tim.



VOREA UJKO

## Albanski trenutek

Rad imam bizantinski zvon  
sredi sinjega neba  
ki se navpično spušča v našo dušo  
ko mrak dobiva barvo ciklame  
in deklet iz sanj  
govori s sklonjeno glavo  
na pragu vrat.  
Tako zaspanemu in osamljenemu  
mi prihajajo pred oči  
gibi otroštva  
in otožni obraz Garantine.  
Iz daljave senc me dohaja  
peket Konstantinovega konja  
ki se približuje s prsmi smrti.  
In odmev arbanaški  
prebija zrak in srce  
se dviguje kot skrivnost  
in s svojimi lahкими krili  
pleza po zidu  
objema molk  
objema mojo kri.

Prevod: S. Kabashi in M. Hanžek



FRANJO FRANCIC

SY FEMIJE

sy fëmijësh  
tha tankisti  
nuk shoh  
qiell parulla  
qiell katror  
shtatëmbëdhjetë vjet  
shtatë vjet burg  
të mos rritesh  
të mplakesh  
për dy fjalë  
kosova republikë  
dy vite apo dhjetë  
për sy fëmije  
të zotit plak  
që qeveris  
që urdhëron  
që kërcnon  
që kamxhikos  
që çirret  
e nuk sheh  
nuk sheh sy fëmijësh

Preved: S. Kabashi in M. Hanëk



FRANJO FRANČIČ

otroške oči

otroške oči  
reče tankist  
ne vidim  
nebo parole  
nebo kvadratov  
sedemnajst let  
sedem let aresta  
da ne odrasteš  
da ne ostariš  
za dve besedi  
kosovo republika  
dve leti ali deset  
za otroške oči  
starca boga  
ki vlada  
ki ukazuje  
ki grozi  
ki biča  
ki se reži  
a ne vidi  
ne vidi otroške oči



## I VETMI ZOT

do të mbysim zot në ty  
thanë ata  
sa zota janë  
vërtetë vetëm një  
ai juaji

## REPRIZE

vjershat i mësonim përmendësh  
atëherë  
një udhëheqës  
një zot  
prap do të mësojmë vjersha përmendësh

## NE PRITJE TE AKSIONIT

ndodhi në maribor  
me mikun shqiptar ndezëm muhabetin  
sa u kall  
çfarë  
të ndrroj babë  
më tha dhe pau në largësi  
droja e guximi  
shtëpia  
e unë  
pa fjalë  
aksioni

Nga sllovenishtja: S.K.



## **edini bog**

ubili bomo boga v tebi  
so rekli  
koliko bogov je  
res samo eden  
in ta samo vaš

## **ponovitev**

pesmi smo se učili na pamet  
takrat  
en vodja  
en bog  
spet se bomo učili pesmi na pamet

## **v času akcije**

bilo je v mariboru  
s preijateljem albancem sva besede gre la  
da so zagorele  
kaj  
naj zamenjam očeta  
mi reče in se zagleda daleč  
strah in pogum  
dom  
jaz pa  
brez besed  
akcija



JURE DETELA, pacifist i njohur slloven:

## PERVOJAT E MIA ME POLICINE

Në këtë tekst do të provoj që në mënyrë kronologjike të përshkruaj përpelitjet e mia me policinë.

Duke përshkruar disa nga lajthitjet e mia do të përpiqem të dëftoj për ato fintent tipike policore, në të cilat njeriu nuk do të duhej të jenë. Përjetimet e numërtat që i përshkruaj këtu, dëshiroj të mos përsëriten tek askush. Njëherit dua të mos përdoren me metodat policore që i parashtroj.

Sjelljet e përshkruara policore do të mund të zhduken vetëm pas transformimit radikal të shoqërisë e të vetëdijes, andaj çdo dëshirë hakmarrjeje mbi milicë të caktuar që kanë tejkaluar autorizimet e tyre, është e gabuar. Pa kuptim është të luftosh kundër njerëzve si individë; ka kuptim të luftosh vetëm atë të keqe që njohim në përmasat botërore. Vetëdija mbi veçoritë e papërsëritshme të një ngjarjeje të rrallë si dhe vetëdija mbi pozitën e papërsëritshme që zë individi në situata të konfliktit, assesi nuk mohojnë vetëdijen mbi dimensionet botërore të së keqes, që sundon mbi situata konfliktit. E dhe xhelati është viktimit më e pozës së tij, e jo vetëm njeriu, të cilin xhelati e mbyt - të gjitha pjesët e botës janë të lidhura midis tyre me fije të panumërtat. Shkurt: çështje qenësore tek problemi i dhunës policore është problemi i edukatës, që i nënshtrohen të rinjtë që në Konviktet e Tacenit/shkolla e milicisë - ver. e përkth./mësojnë për milicë. Edhe tek edukimi në Tacen është qenësor edukimi që i janë nënshtruar organizatorët e sistemit mësimor. Pas këtij vargoi mund të vëmë shumë larg. Porse jo me mendime hakmarrëse, që më me qejf do t'i ndërroj me atë vezullim bleroshe të një nate pranverore që para njëzetë e gjashtë vitesh pat vezulluar mbi Parkun e Tivolit. Dua që para se të vie ajo ditë e pritur kur në asfaltin midis godinës së policisë në Rrugën e Kidriçit dhe të Rrokaqiellit/Neboticnik/ do të digjen të gjitha dosjet policore sllovene në një flakë të mrekullueshme, askush të mos përgatisë veprime hakmarrëse mbi milicët. Nuk dua kurrëfarë represioni



mbi milicët që kanë keqpërdoruar autorizimet e veta, dua prerjen e keqpërdorimeve në të ardhshmen. Sepse metodat e përshkruara policore janë shprehje e smundjeve shoqërore, që janë më të përhapura se sa mendojmë zakonisht.

Në fellutë pak më të madhe me policinë shkallova për herë të parë me fajin tim, para së gjithash nga marrëzia, frika, moshonepsejes ndaj njerëzve dhe papërvoja rinore. Më 9 mars 1974 i lodhur e i pagjumë po ecja nga Pirani në Izola. Pasi i shmangesha rrugës kryesore dhe rrugëve me trafik të dendur, doja buzë detit të arrija në qendër të Izolës. Kështu u gjeta në oborr të Fabrikës DELAMARIS të cilën në një rën anë e lag deti. Shikova tymtarin dhe menjëherë ndjeva një zell të ngjitesha në të. Atëherë më thuproi një kujtim i hershëm kur kisha parë poashtu një tymtar të këtille dhe kur kisha ndjerë të njëjtën dëshirë për zvaritje; dhe ndjeva se kishte qenë përjetim që kam mbajtur mend sepse po përsëritej së paku tri herë. Këto ndjesi më tmerruan. Në një gjendje të këtille më pa rojtari i fabrikës. Ishte e diel dhe ne të dy ishim njerëzit e vetëm në oborr. Rojtari më shpuri në kabinën e tij dhe me telefon thirri policinë, të cilët arritën së shpejti me Fiqën e kaltër dhe pa një pa dy më dërguan në postën e policisë. Atje ashpërsisht thanë që në pyetjet e tyre të përgjigjesha shpejt dhe të mos rrej. Zbrazen trastën time dhe më pyetën prej nga janë sendet që ishin brenda (më kujtohen dy libra e një kasetë). Atëherë njëri nga milicët më tha t'u them çdi për drogat dhe se për këto kam në disponim një çerek ore. Vetë iku. Ajo thënie më preku pak sepse çeshtë e vërteta unë asokohe disa herë kisha shijuar lirin indas dhe mu bë se kanë milicët njëfarë njohurie mistike të fshehtë mbi të gjitha veprimet e mia sado të parëndësishme të jenë ato. Nuk dija se milicët përqendroheshin në pyetjet për drogën tek pjesa më e madhe e të rinjve që sillen panatyrshëm dhe skanë tjetër mundësi pos ti trajtojnë si narkomanë. Ngaqë asokohe isha pak a shumë bestytnik, fitova përshtypjen se po përmbushet njëfarë fati i keq ndaj se cilit jam i pafuqishëm dhe s'ka bojë ti kundërshtoj. Kësodore vendosa të rrefej për dy trupa liri indas.

(vijon)



**Ali Podrimja:**

**TATEPJETES**

Vetëm njëra anë dëgjohet  
Vetëm njëra dritare hapet  
po Dielli pik diku ngjeti

Kur të dëgjohet ana tjetër  
Ana tjetër a do të shurdhohet  
A do të mbyllet dritarja e zgurdulluar

Dielli a do të pikë edhe në çatinë e kërrusur

Dëgjohet vetëm njëra anë  
Vetëm njëra anë  
Dhe gishtat në vesh dhe fishkëllima

Kur të dëgjohet ana tjetër  
A do të harrojë njeriu të lehë  
A do ta zëmë Diellin tatë pjetës

**ME JETOHET**

Lehin zoti im lehin  
E unë skam fjalë

Për tokë kapem  
Mbahem për qiell

Lehin zoti im lehin  
E mua më jeto het



DRITERO AGOLLI

PER GRATE TONA

Sa pak këndojmeë për gratë tona.  
Për gratë të bukura e të mira,  
Që na përkëdheelin me duar të njoma,  
Kur kthemi nga rrugë të vështira.

Gabohemi shumë, kur flasim e grijmë  
rreth gotës me birrë, rreth gotës me verë,  
Se gjoja gratë tona e humbën freskinë,  
Se gjoja ishin të këndshme njëherë...

Ah, vëllezër s'humbet hijeshia e tyre.  
Ato përtrihen, ato lulëzojnë,  
Mjafton të qëndrojnë pak në pasqyrë,  
Dhe bëhen prapë vajza të njoma...

E si të mos këndojmë, poetë,  
Për ato që kanë ditur në jetë  
Të lindin kreshnikë e perri,  
Në maternitet e shtëpi,  
Në mal a në arë  
Duke prerë dru e duke hedhur farë...

(1961)



# ESAD MEKULI

## SODBA O NAS

Za nami pridejo naši otroci in otroci njihovih otrok  
in bodo spregovorili o nas, bodo sodili o nas  
(Rodovi ocenjujo dela...-je dejal veliki  
Nekdo)-

in ne bodo nas obsodili, vem, zaradi našega  
jecljanja, porodnih muk,  
naših napak-majhnih i velikih-za to, kar  
smo ustvarili...

kajti-kdo je kriv, da nam predniki niso zapustili  
skoraj nicesar(drugim dosti)  
razen grobov in neznanja,  
kdo je kriv, da so stoletja-tema in osamljenost-  
kod zgodnji mraz spocetka še kali morila?

Za nami pridejo naši otroci in otroci njih otrok-  
rodovi,  
in vedeli bodo za nas, ker smo veliko  
rojstvo

Novega Dne sonca in ljubezni;  
vedeli bodo za nas, z občudovanjem-vem-  
bodo pripovedovali svojim otrokom,  
kako smo, iz pepela in revščine, gradili...  
z golimi rokami nesmrtnih graditeljev;  
kako smo pisali pesmi, kako zgodbe,  
črkovaje abecedo, besede, jezik...

Za nami pridejo otroci in otroci njih otrok  
in vedeli bodo za nas-svoje hrabre prednike-  
ker pravo življenje se pričanja iz nas, z nami...  
In ne bodo nas,, vem, obsodili za to, kar smo  
dosegli-

ker-kdo je kriv, da nam predniki niso zapustili  
skoraj nicesar(drugim dosti) razen grobov in neznanja,  
kdo je kriv, da so stoletja kot zgodnji mraz



# VOJIN KOVAČ - CHUBBY

## HYRJE NE DRAMEN E PASHKRUAR

do të doja  
të pshurrja zonjën që merret me kanarinat  
do të doja  
t'i vidhja fqit karrigën se s'më pëlqen baroku  
do të deshiroja  
gurët të hudhin njerëz  
do të doja  
të takoj një burrë të tërbuar që kafshon qenin  
do të doja  
kali të kalërojë sipër meje  
do të doja  
macet t'i përlejnjë gjithë vendimet e deratizimit  
do të doja  
t'ia ktheja kurorën që i vodha preshernit

protestoj  
pse bojë e penës thahet saora  
protestoj  
pse pushteti nuk ka ndaluar të lehet në shesh të qytetit  
protestoj  
pse në gazetë s'janë gjithë lajmet për vrasjet  
protestoj  
pse protistutat të mos jenë të mbrojtura  
protestoj  
pse shtrembërohen gozhdat aq shpejt  
protestoj  
pse qeveritarët s'kanë urdhëruar që bretkocat të kenë katër  
këmbë  
protestoj  
pse portokajt të kenë gjithë atë lëvozhgë



kërkoj  
heqjen e menjëhershme të vranësisë  
kërkoj  
vazhdimin e shtatëzanisë për dymbëdhjetë muaj  
kërkoj  
që peshqit menjëherë të shtohen peshqit në Lublanicë

ju lus  
shuani dritën

thërras në grevë urie  
të gjithë ata që janë kundër keqësimit të motit  
thërras në grevë urie  
të gjithë ata që qentë u ndiqen  
thërras në grevë urie  
të gjithë ata që u prish era flokët  
thërras në grevë urie  
të gjithë ata që sorrollaten udhëve bojë ulliri  
thërras në grevë urie  
të gjithë ata që bari u rritet ngadalë  
thërras në grevë urie

Nga sllovenishtja: S.K.



Bajram Dabishevci

## ETHET E MINJVE

Kurrë nuk mundën t'më përçajne  
mua me themelet e lashta të Kështjellës sime,  
sado që shi sixhim...e rrodhën e rrodhën  
ujërat erozive  
hëngrën kaherë tragjizmin e shën rrenës  
komika e mbetur lakuriq domosdo po përplaset  
hendeqeve të rrugëve poshtë...  
Ka mbetur e pastër komika se si i...ngordhur përpiqet  
miu ekspert...rreth pusit të oborrit,  
rreth pusit të Kështjellës.  
Miu i ngordhur, aman ç'punë të mëdha,  
me...klorizimin e...vëllamërisë  
me ujët e burimit...  
Ethet e... trilluara të minjve,  
trillimi me krahët e hapur nga Lindja, Veriu,  
në Jug...

e i falet kërdisë.

Perandoria e miut po heq ore çastet e fundit,  
miu i ngordhur përpiqet me çapat e fundit...  
Paqe moderne,  
paqe moderne.



# DEMË TOPALLI

A MUND TË KTHEHEM PRAPE NE LLUGA

A mund të kthehem prapë në Lluga  
Ku fle pikëllimi i botës  
Zjarri dhe uji që shëron?

Lulen që çel në drurin e tharë  
Ahengun e lënë midis një pylli  
A mund t'i takoj?

Ajo verë e ikur dhe ajo muzikë e shurdhër  
Që vjen si vaj nga zalli i gjallë  
Pse më kërkojnë?

Ajo kremte e mbarë dhe ai fron dovletit  
A do të më mashtrojnë?

## KRONIKA

Do të ma vesh kohën në thikën më të mprehtë  
Që të jem vetëm stoli e rreme  
-Njësoj të ulërijnë ujku dhepra e qeni.

Më dhuron defter mesjete  
Me myhyr mbreti  
Njësoj të ulërijnë ujku dhepra e qeni.

Do t'i bie tejpertej ferrit  
Pa nishan pa fron  
-Njësoj të ulërijnë ujku dhepra e qeni.

Do të më shartosh me gjak të ri  
Dhelparak  
-Njësoj të ulërijnë ujku dhepra e qeni.



**Se lahko spet vrnem v Llugah**

Se lahko spet vrnem v Llugah  
Kjer svetovna žalost spi  
Ogenj in voda ki celita.

Cvet ki cveti v suhem drevesu  
Vzdihljaj spuščjen sredi gozda  
Ali ju lahko srečam.

Tisto izginulo poletje in tista gluha glasba  
Ki kot jok prihajata iz živega peska  
Zakaj me iščeta.

Tista srečna slovesnost in tisti prestol domovine  
Ali me bosta prevarala?

## **Kronika**

Rezala mi boš čas z najostrejšim nožem  
da bom le lažen okras  
- naj enako lajajo volk lisica in pes.

Daješ mi srednjeveški defter  
s kraljevskim prstanom  
- naj enako lajajo volk lisica in pes.

Križaril bom skozi pekel  
brez znamenja brez prestola  
- naj enako lajajo volk lisica in pes.

Križal me boš z novo krvjo  
lisjak  
- naj enako lajajo volk lisica in pes.

Prevod: Gani Rrustem Lipaj



# MIGJENI

## V CERKVI

V našem mestu je četrt... V tej četrti je cerkev. V cerkvi berač, v katerem gori želja: želja po življenju. »Pridite k meni vsi tega sveta, ki ste izgnani in zasmehovani,« je dejal nekoč gospodar te cerkve, »pri meni boste našli navdih...«

Berač je prišel. In resnično je našel navdih. Cerkveni hlad mu je pregnal vročino iz njegovega telesa, ki ga je skoraj žgala. Zunaj je vroče. Sonce je tako noro segreto in te tako divje boža, da čutiš v glavi udarce, kot bi kovač razbijal po žarečem železu.

Kako se je mučil berač, preden je prišel sem. Zaradi vročine ni mogel hoditi hitreje. Lahko bi ga tudi ujeli. Toda vročina mu je tudi pomagala. Policaj, ki mu je sledil, je bil debel; bal se je, da se bo stopil kot mast v ponvi, če se bo še naprej zaganjal za njim. Hudič naj vzame teh pet, šest lekov za katere je berač osumljen, je mislil policaj. Hudič naj jih vzame! Morda jih tudi ni vzel. Berač pa ni hotel priznati. Ne zaradi česa drugega, marveč zato, ker kot pošten človek ne želi pred sodišče. Prav ima! Ali ne delajo enako tudi vodilni trgovci v našem mestu? – In kdo lahko dvomi o njihovi poštenosti? Da prideš pred sodišče nedolžen, pa je v očeh naših ljudi sramota.

Berač je v cerkvi... Sedi na klopi in uživa v hladu. Kako lepo je sedeti, se spočiti in imeti zagotovljen kruh za dva dni... Šest lekov! Tudi tri dni lahko živiš s šestimi leki. Eden, dva, tri, štiri, pet, šest lekov. Cink, cink, cink, cink, cink! Duhovnik za oltarjem se moti zaradi zvena kovancev. Pokuka izza ikone nekega svetnika. Vendar nič! Vidi le berača, ki moli s sklenjenimi rokami. Tudi neiznajdljivi berač ga gleda. Boji se. Skoraj bi verjel, da se bo zgodil čudež. Toda ne! Bila je samo padrejeva glava. Zbral se je. Ko je glava izginila, je berač s še večjim sanjarjenjem spet začel božati šest lekov; bil jih je bolj vesel kot izdajalec Iškarijot svojih tridesetih, ki jih je dobil, ko je prodal svojega in padrejevega Učitelja. V tem sanjarjenju je berač počasi zaspal na zadnji cerkveni klopi, njegovo spanje je bilo mirno, kot je mirno spanje ljudi brez življenjskih skrbi.

Cerkvena tišina je začela izginjati... Črne in rdeče kape, modre in bele obleke, svilene in bombažne nogavice, obrazi z brki in brez njih, nasmejani in spačeni – verniki se zbirajo k poslušanju popoldanskega pridigarja. Klopi so polne. Na zadnji pa sedi berač.



»Res, resnično vam povem,« odmeva padrejev glas in nasuje dež in točo nad grešnike. Vsi verniki so si čistili in umili ušesa in zelo dobro slišijo. Starejši ostajajo odprtih ust. Neka starka se simbolično smehlja. Dve mlajši se prepirata z gibi rok: »Ali se je padre obril danes ali včeraj?« Neko dekle uživa v mavričnih žarkih, ki so skozi raznobarna okna osvetlili padrejevo kuto... Govor teče zelo dobro. Toda ko je padre začel groziti tistim, ki kradejo, in se je tako lotil beračeve intimnosti, je berač vstal, šel ven, in pri vratih, ko je poln sovraštva počastil pridigarja s kletvico, zamrmral: »Kako pa naj jaz živim?... Tega mi nisi nikoli povedal. Živeti pa moram!«

## PREPOVEDANO JABOLKO

Tridesetletnik. Brezposeln. Stoji pred reklamami za kino, čeprav je delovni dan. Fuj, pljune in obrne glavo proč. Zdelo se mu je, da ga nekdo kliče... Toda ne. Nihče ga ne kliče. Nihče ne potrebuje delavcev. On pa mirno, mirno nadaljuje s svojim vsakdanjim delom: ogleduje si reklamo za kino. No ja! Ti pa res živijo, pravi in se približa, da bi lahko še natančneje študiral. Vsakdanji film vrtijo – lepo dekle in ob njej lep moški. Nevoščljivost v očeh delavca. Čuti sovraštvo do igralca. Grdo ga gleda. Pljune. Gleda svojo obutev. Tudi sam ne ve, kaj je to. Inkarnacija čevljev, škrpet. Pripogne se, zveže škrpet z vrvico, vse to pa pospremi z vzdihom. Vzravna se. Hodi – po pločnikih, se razume. Tudi čisto bos bi lahko hodil po pločnikih, zakaj pa ne!

Premika se počasi, zbran je. Kot vsak brezposelni. Tudi drugi hodijo, toda niso zbrani – nemirni so. Kako lepo je biti zbran, hoditi počasi kot gospod. Kaj pa govorim? – Je dobro, da hodiš zbran in počasi?... Ne in da! Da in ne! Kakor se vzame... Za gospoda je dobra počasna hoja, da se mu hrana poleže, za delavca ni dobro, da hodi počasi. Zakaj? – Veste. Vendar delavec še naprej hodi počasi, s popolno zbranostjo in udobnostjo. Nič slabše od kakšnega gospoda. Kaj moreš? Takšen je današnji čas... in svet. Tudi če nočeš biti gospod, to postajaš. Delavec noče biti gospod, pa tudi imitirati gospoda ne bi hotel, vendar čas... ne ljubi se mu! Ni mu všeč takšne vrste gospodstvo. Ne zaradi utrujenosti – marveč... no, saj tudi to veste.



Tam-tam-tam-tam! Štiri popoldne je že! Štirje udarci ure se slišijo iz svetega stolpa in odmevajo v hudičev želodec delavca. Štiri! Štiri! Štiri! Povsod štiri! In zakaj štiri? Zakaj? Zakaj štiri? Nesporazum. Nesoglasje: nekaj kot revolucija. Revolucija v miniaturi. Poka... top... Ne, želodec od lakote.

Delavec nadaljuje hojo korak za korakom. Išče delo. Kot njegovi tovariši v Berlinu ali pa v Londonu. Nikjer polne samokolnice, da bi jo izpraznil. Nikjer potnikov s prtljago, da bi jim pomagal. Nikjer! Nikjer! Nihče noče njegovega znoja. Pri nikomer ne more zaslužiti dveh, treh lekov.

Delavec se ustavlja pred trgovinami in gleda skozi steklo. Gleda in občuduje romantični čas. Pred steklom papirnice: spet igralci! Škriplje z zobmi. Od jeze dvigne pesti, da bi... kaj pa zakon! Policaj, ga prešine. Podcenjujoče zapusti igralce. Pljune. Nadaljuje. Spet pljune. Gleda desno in levo. Pljune.

Lačen in propadel hodi ob prodajalnah, polnih »prepo-vedanih jabolk« (biblijska zgodba).

Instinkt hoče na dan. Delavec se obvlada! Zakon! Polici-ja!

Zaradi varnosti položi roke na hrbet. Tudi hudiča bi zgrabil za vrat in ga zadavil. Toda tudi hudiča ščiti zakon.

Tam-tam-tam-tam. Do kdaj tako naprej?

**Prevedel Nikolla Berishaj**



# JURE DETELA

## DISKRIMINIMI I FËMIJËVE NË TETOVË

Në artikullin e botuar më 27 nëntor 1988, në faqen e 19 të Nedeljski Dnevnikut, Marjana Vonçina pyet pse në paraqitjen time në nëntor në Cankarjev Dom të Lubjanës u shpreha kundër ligjit demografik të Komunës së Tetovës që u mohon shtesat e fëmijëve që kanë lindur në familjet me dy a më shumë fëmijë.

Kjo s'është e vërtetë. Jam paraqitur kundër masës që është shumë më brutale nga masa që përmend Marjana Vonçina: kundër ligjit mohon mbrojtjen shëndetsore falas për fëmijët e lindur në familjet me dy a më shumë fëmijë. Nuk di se për të pavërtetën në artikull është fajtor raporti nga Nova Makedonija, të cilin autorja e citon apo ndonjë dezinformim tjetër; veçse nga artikujt e botuar në DELO të 18 janarit 1988 dhe në MLADINA të 3 qershorit 1988, bëhet plotësisht e qartë se në Komunë të Tetovës, vlen ligji që fëmijëve të familjeve që tejkalojnë katër anëtarë, u mohon sigurimin shëndetsor, prandaj mendoj se në Cankarjev Dom këtë fakt e kam formuluar pa mëdyshëm dhe qartë.

Në tekstin e Marjana Vonçinës është edhe një e pavërtetë. Kurrë s'kam thënë se është krim "përpjekja e çdo mjeku në Komunë të Tetovës që gjatë kryerjes së detyrës mjeksore kontribuon në zvogëlimin e lindshmërisë së shqiptarëve". Porse kam thënë se është krim çdo abortus dhe çdo shkurtim i mjekimit falas për fëmijët e diskriminuar. Jam koshient se duhet gjatë shqyrtimit të problemeve demografike, të jemi shumë të përpiktë, kështuqë hudhja e qëndrimeve të mia në mënyrë të thjeshtësuar e të përgjithësuar, është jokorrekte. Përdorimi i kondomeve e diafragmave, pas mendjes sime s'është krim. Propagandimi i të përmajturit seksual e të "ruletës vaticanase" në emër të zvoglimit të natalitetit, poashtu nuk është krim. Poashtu pilulat që me siguri shkatërrojnë spermat para se të vie deri tek frytnimi, e që sidomos nuk shkaktojnë ndonjë rrezik ndaj vezëve tashmë të mbarsur, nuk i hedh a priori; edhe tek këto



pilula paraqitet pyetje e rëndë etike rreth procedurës së eksperimentimit e të sprovimit, aniqë kësaj radhe këtë çështje nuk do t'a shqyrtoj. Patjetër se, përdorimi i pilulave që disa orë pas mbarësimit mbysin vezët e mbarësuar, është krim dhe vrasje.

Do të mashtroheshin ata që do të mendonin se kundërshtimi im abortuesit, është i vetmi shkak për kundërshtimin tim ligjit tetovar. Është e vërtetë se ky ligj është i mbrapshtë me vetë faktin se nxit drejtëpërdrejte abortusin. Është e vërtetë se jam kundërshtar i pakusht i çdo abortusi, edhe pse të kundërshtosh ligjin tetovar, s'ke pse të pajtohesh me këtë qëndrim timin. Arsyeja kryesore pse kam kundërshtuar ligjin tetovar është fakti se ai ligj mohon barazinë midis fëmijëve të familjeve të mëdha dhe të fëmijëve të familjeve të vogla. I huaj është për mua çfarëdo diskriminimi para ligjit, sidomos diskriminimi midis fëmijëve më tmerron. Poqese edhe fëmijët e rritur nuk janë të mbrojtur para diskriminimit eksplicit ligjor, atëherë kemi të rrënuara ndjesitë themelore të drejtësive sociale. Ligji i Tetovës, qartas është në kundërshtim të plotë me konventa ndërkombëtare të numërta që ndalojnë diskriminimin e fëmijëve para ligjeve. Në nenin 24 të Paktit mbi të drejtat qytetare e politike, që e ka ratifikuar Jugosllavia, është ky përcaktim:

"Cdo fëmijë, pa dallim race, ngjyre, gjinie, gjuhe, besimi fetar, kombësie a prejardhjeje sociale, pasurie a lindjeje, ka të drejtë në masat mbrojtëse të familjes, shoqërisë e shtetit për shkak të pozitës së tij prej të miturit".

Në pikën e dytë të Deklaratës mbi të Drejtat e Njeriut, gjejmë të shkruar:

"Fëmija duhet të gëzojë mbrojtje të veçantë dhe me ligje e me mjete të tjera, duhet t'i mundësojmë kushte e lehtësime, që ai të zhvillohet në pikepamje trupore, mentale, morale e shoqërore në konditat e lirisë e të dinjitetit. Shtytje kryesore për aprovimin të ligjeve të tilla le të jenë interesat e fëmijëve".

Kushtetuta kërkon të jetë në harmoni me konventat ndërkombëtare që ka nënshkruar Jugosllavia. Nga kjo pikë



ligji tetovar është antikushtetues. Por e drejta që dikush të shoh veten mbrojtës të barazisë, nuk është punë e kotë. Jugosllavia angazhohet për barazi midis jugafrikanëve negër me të bardhët, çka duhet lavdëruar, mirëpo kur duhet në Kuvend të vendosen ndëgjonjëset e të punësohen përkthyesit simultanë, menjëherë lindin problemet. Të dhënat mbi dendësinë e popullsisë, papunësisë e varfërisë janë ngjethëse dhe na vënë para dilemës: a të heqim dorë nga parimi për drejtësi, barazi dhe që veten ta kemi mbrojtës të barazisë, apo të paguajmë për këtë barazi çmimin që kërkon mjerimi tetovar? Unë angazhohem për alternativën e dytë. Lexuesit të mos trishtohen për çmimin e madh që duhet paguar për barazinë e fëmijëve shqiptarë. Të kujtojmë disa nga shembujt e shumtë historikë.

Cfare çmimi pagoi Gandhi për të drejtën që në veten e tij të shohë mbrojtësin e harixhanëve me përfaqësuesit e kastave më të larta? Çmim pagoi padër Niemöller për të drejtën që më 1938, guxoi të konsiderojë mbrojtës të barazisë së ebrejve me "arianët"? Shtatë vite të Dachaut... Sa njerëz para 20 vjetësh u burgosën në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pasi që me bojkotimin e shërbimit ushtarak, dëshmuan angazhimin e tyre për barazi të vietnamezëve me amerikanët. Shembujt janë të panumërt. Shkurt: angazhimi ynë për barazi vërtetohet e dëshmohet vetëm në situata të rënda, derisa demokracia është e siguruar vetëm në shoqërinë, anëtarët e së cilës janë të gatshëm të paguajnë çmimin e lartë të dëshmisë së atij angazhimi. Marjana Vonçina tërheq vërejtjen në varfërinë tetovare; shihet qartas se në emër të këtij fakti, është e gatshme të heq dorë nga parimi për barazi. Mirëpo, akemi arsye që në emër të luftës kundër fakteve të vërteta të pakëndshme, të përdorim mjete të këtilla? Ku janë kufijtë e kësaj logjike? Shumica e barbarive më të tmershme në histori, janë bërë duke marrë parasysh "faktet e vërteta", apo me fjalë të tjera: ekzekutorët e dhunës gjithnjë arsyetojnë egërsinë e tyre me "faktet e vërteta".



Tmerrohem nga qëndrimi i Abdulla Ademit, kryetarit të Komunës së Tetovës se ligji i përmendur nuk është aprovuar "pse nuk duam fëmijët, po pse i duam shumë". Kjo don të thotë se guxojmë që, në emër të shpëtimit të fëmijëve nga dendësia e madhe, të diskriminojmë fëmijë të caktuar dhe t'u mohojmë mbrojtjen shëndetsore. Fëmijët pa mbrojtje shëndetsore, pra, le t'i terrorizojmë që mbi ato viktima të ngritet gëzimi i fëmijëve të tjerë. Sipas kësaj logjike, angazhimi për leverditë e shumicës japin të drejtë egërsie mbi viktima të caktuara dhe, prapë shtrojmë pyetje: ku janë kufijtë e kësaj logjike? Mohimi i mbrojtjes shëndetsore, assesi nuk është diskriminim naiv e i vogël. C'bejnë mjekët e Tetovës me fëmijët e diskriminuar që kanë nevojë për ndihmë mjeksore po që prindërit s'janë në gjendje të paguajnë? I lënë, në fund të fundit, të vdesin në emër të dashurisë ndaj fëmijëve që për gëzimin e tyre kanë nevojë të kufizojnë shtimin demografik? Nëse kemi të drejtë që me egërsi të tilla ndaj fëmijësh, të frikësojmë prindërit potenciale, duke i kthyer nga qëllimi që të kenë fëmijë tjerë-çka është e drejtë e tyre, ku janë atëherë kufijtë e egërsisë? Pse, bie fjala, sipas kësaj logjike, të mos kemi të drejtë të zaptojmë me pranga prindërit e fëmijët e tyre ti mbysim duke i munduar gjatë sepse kanë lindur të tepërt në familje të mëdha? Kjo, mbase, do t'ishte metodë e sukseshme frikësimi që njerëzit të lënë lindjet e tepërta: këtë, merret vesh, nuk do ta bënim "pse fëmijët nuk i duam po pse i duam shumë"; kështu do t'ishte e pëlqyeshme që veglat për shkaktimin e mundimeve, ti emërtojmë, bie fjala, "elektrodë e dashurisë gjithëpërfshirëse,"spirale e vëllazërim bashkimit", "sharrë-cirkular dashurie për fëmijët", etj..



## DISKRIMINACIJA OTROK V TETOVU

V članku, ki je bil 27. novembra 1988 objavljen na 19. strani Nedeljskega dnevnika, se Marjana Vončina sprašuje, zakaj sem na zboru slovenskih kulturnih delavcev, ki je bil novembra 1988 v Cankarjevem domu v Ljubljani, nastopil proti demografskemu zakonu tetovske občine, ki odreka otroške dajatke tistim otrokom, ki so se rodili v družinah z dvema ali več otroki.

To ni res. Nastopil sem proti ukrepu, ki je še veliko brutalnejši od ukrepa, ki ga omenja Marjana Vončina: proti zakonu, ki odreka brezplačno zdravstveno varstvo tistim otrokom, ki so se rodili v družinah z dvema ali z večimi otroki. Ne vem, ali je za neresnico v članku krivo poročilo iz Nove Makedonije, na katerega se avtorica sklicuje, ali kaka druga dezinformacija; toda iz člankov, ki sta bila objavljena v Delu 18. januarja 1988 in v Mladini 3. junija 1988, je popolnoma jasno, da v tetovski občini velja zakon, ki otrokom iz družin, ki presegajo štiri člane, odreka brezplačno zdravstveno zavarovanje, in mislim, da sem v Cankarjevem domu to dejstvo dovolj jasno in nedvoumno formuliral.

V tekstu Marjane Vončina je še ena neresnica. Nikoli nisem rekel, da je zločin "poskus vsakega zdravnika v tetovski občini, ki pri opravljanju zdravniške dolžnosti prispeva k zmanjšanju rodnosti Albanc". Rekel pa sem, da je zločin vsak abortus in vsako odrekanje brezplačne zdravniške pomoči diskriminiranim otrokom. Zavedam se, da je treba biti pri obravnavanju demografskih problemov skrajno natančen, zato je zavračanje mojih stališč s poenostavljajočimi in posplošujočimi obnovami nekorektno. Uporaba kondoma in diafragme po mojem mnenju ni zločin. Propagiranje spolne vzdržnosti in "vatikanske rulete" v imenu zmanjšanja natalitete tudi ni zločin. Tudi tablet, ki z gotovostjo ubijejo



semenčice, še preden pride do oploditve, in ki zagotovo ne povzročajo nobene nevarnosti, da bi ubile že oplojeno jajčece, ne zavračam a primeri; tudi pri teh tabletah se postavlja težko erotično vprašanje o postopkih, s katerimi so bile preizkušene, vendar se zdaj v to vprašanje ne bom spuščal. Pač pa je uporaba tablet, ki nekaj ur po zanositvi ubijejo že oplojeno jajčece, zločin in umor.

Vendar bi se motil, kdor bi mislil, da je moje nasprotovanje abortusom edini razlog za moje odklanjanje tetovskega zakona. Res je, da je tetovski zakon med drugim pošasten tudi zato, ker neposredno vzpodbuja k abortusom. Res je tudi, da je odnos do najbolj prezrtih in najbolj nezaščitenih, na primer odnos do živali in embiov, tisti preizkusni kamen, pri katerem odpove vsaka morala, ki temelji le na pogodbi ali na konsenzu in se zato izključuje s tistim univerzalizmom, ki upošteva tudi najbolj prezrte in najbolj oddaljene in ki je za etiko neizogiben. Res je, da sem zato brezpogojen nasprotnik vsakega abortusa, vendar za nasprotovanje tetovskemu zakonu sploh ni potrebno strinjanje s tem stališčem. Poglavitni razlog, iz katerega sem zavrnil tetovski zakon, je dejstvo, da ta zakon odreka enakopravnost otrokom iz velikih družin z otroki iz majhnih družin. Odvratna mi je vsaka diskriminacija pred zakoni, diskriminacija med otroki pa mi je še posebej odvratna. Če niti mladoletni otroci niso zaščiteni pred eksplisitno zakonsko diskriminacijo, je oskrunjen vsak najosnovnejši čut za socialno pravičnost. Tetovski zakon je v očitnem nasprotju s številnimi mednarodnimi konvencijami, ki prepovedujejo diskriminacijo otrok pred zakoni. V 24. členu Pakta o državljanskih in političnih pravicah, ki ga je Jugoslavija ratificirala, je tole določilo:

"Vsak otrok brez razlike glede na raso, barvo, spol, jezik, veroizpoved, narodnost ali socialno poreklo, imetje ali rojstvo ima pravico do zaščitnih ukrepov s



strani svoje družine, družbe in države, ki jih zahteva njegov položaj mladoletnika."

V 2. načelu Deklaracije o človekovih pravicah je zapisano tole:

"Otrok mora biti deležen posebne zaščite in z zakonom ali drugimi sredstvi mu moramo omogočiti razmere in olajšave za to, da se razvija na telesno, mentalno in družbeno zdrav način in v pogojih svobode in dostojanstva. Glavna pobuda za sprejetje zakonov, ki bodo težili k temu cilju, naj bodo kar največje koristi za otroke."

